

URDHËR
Nr.193/3, datë 15.5.2020

**“PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 193, DATË 20.3.2020 “PËR
MBYLLJEN APO KUFIZIMIN E LËVIZJEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7, pika 4, dhe 15, të ligjit nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, si edhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr.193, datë 20.03.2020 “Për kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi si vijon:

1. Fjalja e fundit e pikës 3, ndryshohet si më poshtë:

“Përfundim nga ky rregull bëhet për pikat e shitjes së produkteve ushqimore me pakicë dhe farmacitë, të cilat ditën e shtunë, datë 16 maj 2020, lejohen të ushtrojnë aktivitetin e tyre deri në orën 17:30.”

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu